

Bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 75 dhe VKA nr. 5, datë 14. 08. 2020 “Për shtesa e ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” dhe sipas Urdhrit nr. 33 Prot., datë 14.11.2022, të Drejtorit të DRSSH Korçë “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit, nëpërmjet konkurimit të hapur”, DRSSH Korçë shpall vend të lirë pune për pozicionin:

### **DRSSH Korçë**

1. Inspektor bujku / Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore Devoll.

1 vend pune

### **Kandidati konkurues**

- Diplomë Universitare e Nivelit të Parë / Bachelor/ të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të Arsimit të lartë;

### **Kërkesat e përgjithshme specifike**

Kandidati që konkuron duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista**

Kandidati do të testohet në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e sigurimeve shoqërore (statusi i ISSH-së, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar);
- Njohuri të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare, personelit dhe për sistemin e informacionit të ISSH;
- Njohuri të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b) vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- c) intervista me gojë, ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkuron.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, **deri në 20 pikë;**
- b) për intervistën me gojë, **deri në 40 pikë;**
- c) për vlerësimin me shkrim, **deri në 40 pikë.**

Kandidati konkurues kualifikohet nëse në total ka fituar **mbi 70 pikë** nga 100 pikë të mundshme, gjatë fazës së vlerësimit.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidati duhet të dorëzojë në zyrën e protokollit, DRSSH Lezhë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin është i interesuar;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të Kartës së identitetit.

**Dorëzimi i dokumentave:**

Personat e interesuar për të qenë pjesëmarrës në konkurim duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar **brenda datës 22.11.2022**, pranë zyrës së protokoll/sekretarisë, në DRSSH Korçë.

Nuk pranoen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

**Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Korçë, në datën **25.11.2022, ora 10.00.**

**Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Korçë, në datën **30.11.2022, ora 10.00.**